



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



## Analizë dhe vlerësim i Qendrave të Votimit në Kosovë

Tetor, 2022

© [2022] - [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve].

Raporti “Analizë dhe vlerësim i Qendrave të Votimit në Kosovë” u hartua nga zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

Besnik BUZHALA, Udhëheqës i Divizionit për Shërbim të Votuesve,

Lirik KRASNIQI, Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve, dhe

Premtim RRUSTEMI, Zyrtar i Lartë i Bazës së të Dhënave.

Përmbytja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës.

[www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

Ruga Migjeni, Nr. 21

10 000, Prishtinë

Republika e Kosovës

<b>PËRMBAJTJA</b>		
<b>Kapitulli</b>	<b>Titulli kapitullit</b>	<b>Nr. i faqes</b>
<b>1</b>	<b>Hyrje</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Përshkrimi i problemit</b>	<b>4</b>
<b>3</b>	<b>Metodologjia e procesit të vlerësimit të qendrave të votimit</b>	<b>5</b>
<b>4</b>	<b>Përbledhja e të dhënët nga Drejtori të e Arsimit nëpër komuna</b>	<b>6</b>
<b>5</b>	<b>Rekomandimet për Qendrat e reja të Votimit</b>	<b>7</b>
5.1.	Caktimi i votuesve sipas adresave (emrave të rrugëve)	8
5.2.	Ndryshimet pas caktimit të votuesve sipas adresave (emrave të rrugëve)	9
5.3.	Aktivitetet që duhet të ndërmerrin në të ardhmen	11
5.4.	Rekomandimet	12
<b>6</b>	<b>Mbyllja e Qendrave aktuale të votimit</b>	<b>13</b>
6.1.	Mbyllja e qendrave të votimit	13
6.2.	Shkrirja e Qendrave të votimit në një qendër të votimit	14
<b>7</b>	<b>Vlerësimi i Qendrave split të votimit</b>	<b>16</b>
7.1.	Përbledhje	16
7.2.	Qendrat split të votimit	17
7.3.	Rekomandimet	18
<b>8</b>	<b>Vlerësimi i vendvotimeve për Qendra të Votimit</b>	<b>19</b>
8.1.	Përbledhje e të dhënave për numrin e vendvotimeve	19
8.2.	Vlerësimi i hapësirave të qendrave të votimit nga ZLKZ-të	19
<b>9</b>	<b>Lista e Qendrave të Votimit</b>	<b>21</b>
9.1.	Përbledhje	21
9.2.	Kodifikimi i Qendrave të Votimit	21
9.3.	Renditja e Qendrave të Votimit sipas numrave rendore	22
9.4.	Emërtimi i objekteve që shfrytëzohen si Qendra të Votimit	22
9.5.	Rekomandimet	23

## 1. Hyrje

Qendra e votimit është një vend apo hapësirë, ku votuesit mund të hedhin votën e tyre në raport me zgjedhjet e caktuara.

Si qendra të votimit zakonisht shfrytëzohen objektet publike, të cilat përdoren për qëllime tjera, e që në masë të madhe këto objekte shfrytëzohen si shkolla, salla sportive ose zyra të pushtetit lokal.

Në rastin e Kosovës, qendra e votimit zakonisht nënkupton objektin shkollorë, i cili përbëhet nga hapësira të brendshme të ndara, ku këto hapësira në ditën e zgjedhjeve përdoren si vendvotime, dhe votuesit në këto vendvotime ndahen sipas renditjes alfabetike të mbiemrave.

Në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura me datën 17 tetor 2021, votuesit janë caktuar që të votojnë në tetëqind e tetëdhjetë e tre (883) qendra të votimit dhe në dymijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë (2,477) vendvotime. Numri i votuesve të caktuar në qendra të votimit për këto zgjedhje, ka qenë 1,885,448.

Në Kosovë, nga 883 qendra të votimit gjithsejtë, 148 qendra të votimit gjenden në zonat urbane të komunave, që përbën 16.76%, ndërsa 735 qendra të votimit gjenden në zonat rurale të komunave apo në fshatra, që përbën 83.23%.

Në 148 qendrat e votimit që gjenden në zonat urbane kanë qenë të caktuar 796,256 votues, apo 42.23% e votuesve. Ndërsa, në 735 qendra të votimit që gjenden në zonat rurale të komunave apo në fshatra, kanë qenë të caktuar 1,086,192 votues, apo 57.60% e votuesve.

Përmes kësaj analize, KQZ synon që t'i arrijë së paku tri rezultate:

- a) Marrjen e informatave nga drejtoritë e arsimit nëpër komuna për objektet shkollore që nuk shfrytëzohen si qendra të votimit me qëllim të hapjes së qendrave të votimit në zonat urbane,
- b) Hapjen e qendrave të votimit në zonat urbane, dhe zonat rurale ku është e nevojshme,
- c) Vlerësimin e qendrave split të votimit, që si kriteri të caktimit të votuesve kanë shkronjën e parë të mbiemrit, me qëllim të mos përdorimit të këtij kriteri në zgjedhjet e ardhshme, dhe
- d) Vlerësimin e qendrave aktuale të votimit, me qëllim të shfrytëzimit të hapësirave apo vendvotimeve që gjenden në katin përdhese të objekteve që shfrytëzohen si qendra të votimit.

## 2. Përshkrim i problemit

Lista e votuesve në Kosovë krijohet nga të dhënrat e ekstraktit më të vonë të regjistrat qendor civil, që merret nga Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve në kuadër të Agjencisë për Regjistrim Civil (Ministria e Punëve të Brendshme). Kjo mënyrë e krijimit të listës së votuesve përbën sistemin pasiv.

Ndërsa, procesi teknik i krijimit të listës së votuesve nënkuption caktimin e votuesve në qendra të votimit. Ky proces bazohet në P-Kode dhe UD-Kode, të cilat shërbejnë si elemente shënjuese për vendbanimin apo adresën. Kjo mënyrë e caktimit të votuesve nëpër Qendra të Votimit nuk garanton saktësi, pasi qe përdorimi i P-Kodeve dhe sidomos i UD-Kodeve ka kohë që nuk është zbatuar saktë nga komunat, përgjatë procesit të pajisjes së shtetasve me dokumente të identifikimit.

Caktimi i votuesve duke i përdorur sidomos UD kodet dhe P-kodet gjeneralë ka sjellë fenomenin e përfshirjes së shume votuesve në disa qendra të votimit që gjenden në pjesët urbane të komunave dhe për rrjedhojë ka shkaktuar mbi ngarkimin e këtyre qendrave të votimit nga numri i madh i votuesve.

Përfundimisht, bazimi në P-Kode dhe UD-Kode tani më e ka vështirësuar përcaktimin e drejtë dhe të saktë të votuesve në qendrën e votimit dhe gjithashtu mos ndërlidhja e sistemit unik të adresave në të dhënrat e shtetasve të Kosovës në Regjistrin Qendor Civil, i ka pamundësuar KQZ-së, që votuesit t'i caktoj sa më saktë në qendra të votimit.

Duke u gjendur në këtë situatë, KQZ do të detyrohet të ndërmarrë hapa konkret, në themelin qe qendrave të votimit në zonat urbane, të cilat përvèç se do të mundësojnë që votuesit të votojnë sa më afër vendbanimit të tyre, hapja e qendrave të votimit në disa raste do të ndikojnë në zvogëlimin e numrit të votuesve nga ato qendra të votimit ku tashmë janë të ngarkuara.

Caktimi i votuesve në qendrat e votimit në zonat urbane do të bëhet përmes adresave aktuale që kanë votuesit. Kjo mënyrë e caktimi nuk do të garantoj caktim të saktë për shkak që të dhënrat e regjistrat qendor civil nuk përbajnë ose përbajnë fare pak, numrat e hyrjeve (objekteve të banimit). Kjo sidomos do të ndikojë në caktimin e saktë të votuesve, të cilët kanë vendbanim në rrugë të gjata, ku gjatë kësaj rrugë gjenden më shumë se një objekt që shfrytëzohet si qendër e votimit. Për shembull, në komunën e Prishtinës, rruga Haxhi Zeka, fillon nga objekti shkollor Ahmet Gashi (që shfrytëzohet si QV) dhe vazhdon deri të lagja Kolovicë. Përgjatë kësaj rrugë, ekzistonë dy qendra të votimit dhe dy që janë rekomanduar të themelohen si të tilla. Qendrat ekzistuese afër kësaj rrugë janë: Qendra e votimit në shkollën Ahmet Gashi dhe Qendra e Votimit në shkollën Pjetër Bogdani dhe për dy objektet të rekomanduara që të shfrytëzohen si qendra të votimit, shkolla e Gjelbër dhe shkolla Xhavit Ahmeti në Kolovicën e Re.

### 3. Metodologjia e procesit të vlerësimit të qendrave të votimit

Para fillimit të analizës dhe vlerësimit të qendrave të votimit, Departamenti i Koordinimit në Terren dhe Divizioni i Shërbimit të Votuesve, kanë përcaktuar veprimet që duhet të ndërmerren dhe periudhën kohore të përmbushjes.

Kjo metodologji ka shërbyer që hap pas hapi të ndërmerren veprimet konkrete, me qëllim të përmbushjes së këtij aktiviteti.

Tabela 1: Përshkrimi i veprimeve të ndërmarrë dhe periudha kohore e realizimit.

Veprimet e ndërmarrë	Përshkrimi i veprimit	Periudha kohore e realizimit
1	Kërkesë për Drejtoritë Komunale të Arsimit lidhur me mbledhjen e të dhënavë të objekteve shkollore për çdo komunë	06 – 16 maj 2022
2	Vlerësimi i qendrave aktuale të votimit lidhur me shfrytëzimin e hapësirave që përdoren si vendvotime	Maj – gusht 2022
3	Mbledhja e të dhënavë me emrat e rrugëve, për objektet shkollore të propozuara si qendra të votimit në zonat urbane	22 qershor – 10 gusht 2022
4	Identifikimi i votuesve sipas emrave të rrugëve duke u bazuar në të dhënat e Listës Përfundimtare të Votuesve 2021	1 gusht – 16 gusht 2022
5	Takim me ZLKZ-të që kanë rekomanduar themelimin e qendrave të votimit	17 gusht 2022
6	Dërgimi i raportit për komente tek Sekretariati i KQZ dhe ZLKZ-të	17 gusht – 24 gusht 2022

#### **4. Përbledhja e të dhënave nga Drejtoritë e Arsimit nëpër komunat e Republikës së Kosovës**

Zyrtarët e Lartë Komunal Zgjedhor, kanë bërë identifikimin e objekteve shkollore, të cilat nuk shfrytëzohen si qendra të votimit.

Gjithsejtë, janë identifikuar nëntëdhjetë (90) objekte publike që nuk shfrytëzohen si qendra të votimit.

- a. 73 objekte janë identifikuar në zonat urbane të komunave të Republikës së Kosovës.
- b. 17 objekte janë identifikuar në zonat rurale/ fshatra të komunave të Republikës së Kosovës.

Nga 90 objekte publike:

- a. 60 objekte shfrytëzohen si shkolla filllore të mesme të ulëta.
  - b. 22 objekte shfrytëzohen si shkolla të mesme të larta.
  - c. 4 objekte universitare.
  - d. 3 salla sportive.
  - e. 1 objekt komunal.
- 

A. 90 objekte publike janë identifikuar për 27 komuna të Republikës së Kosovës.

---

B. Shtatë (7) komuna kanë deklaruar se të gjitha shkollat që përdoren si qendra të votimit janë të mjaftueshme dhe rrjedhimisht nuk kanë dërguar të dhëna për objektet shkollore që nuk shfrytëzohen si qendra të votimit. Të tillë janë: Deçani, Dragashi, Novobërda, Rahoveci, Hani i Elezit, Parteshi dhe Kllokoti.

---

C. Në një (1) komunë nuk ka zyrtar të lartë të angazhuar: Lipjani.

---

D. Dy (2) komuna kanë nga një qendër të votimit, që konsiderohen të mjaftueshme. Të tillë janë: Juniku dhe Mamusha.

## 5. Rekomandimet për Qendrat e reja të Votimit

Me datën 22 qershor 2022, përmes e-mailit, ZLKZ-të kanë pranuar udhëzimet dhe formën për plotësim të emrave të rrugëve.

Përbledhja e të dhënavë me emrat e rrugëve, është bërë duke u referuar në zonimin e shkollave sipas të dhënavë zyrtare (hartave) dhe sipas vlerësimeve të ZLKZ-ve, se emrat e rrugëve të listuara i përkasin objekteve shkollore të cilat janë rekomanduar për tu hapur si qendra të votimit.

Dymbëdhjetë (12) komuna kanë dërguar të dhënat me emrat e rrugëve për objektet shkollore që kanë rekomanduar të hapen si qendra të votimit. Ndërsa, një komunë ka rekomanduar hapjen e qendrave të votimit në dy fshatra.

A: Njëzet e nëntë (29) qendra të votimit janë rekomanduar të hapen në zonën urbane të komunave, dhe

B: Gjashtë (6) qendra të votimit janë rekomanduar të hapen në zonën rurale (fshatra).

Tabela 2: Numri i kërkesave për hapjen e qendrave të reja të votimit sipas komunave

Kodi Komunal	Komuna	Nr. i QV-ve në zonën urbane	Nr. i QV-ve në zonën rurale
03	Gjlogoc	0	2
02	Gjakovë	2	0
04	Gjilan	4	0
07	Kaçanik	1	0
08	Klinë	1	1
09	Fushë Kosovë	1	0
11	Mitrovicë e Jugut	2	2
18	Podujevë	2	0
19	Prishtinë	7	0
20	Prizren	3	0
25	Suharekë	2	0
25	Ferizaj	3	0
27	Vushtrri	1	1
<b>TOTALI</b>		<b>29</b>	<b>6</b>

Pas rekomandimeve për krijimin e qendrave të reja të votimit dhe vlerësimit të qendrave aktuale të votimit, të cilat pas vlerësimit janë shuar ose shkrirë në një qendër të votimit, numri i qendrave të votimit është: 905. Tridhjetë e pesë (35) QV janë rekomanduar të hapen.

**Për më shumë informata, pjesë e këtij rapporti, është Shtojca 1: Përbledhje për numrin e qendrave të votimit sipas komunave.**

## 5.1. Caktimi i votuesve sipas adresave (emrave të rrugëve)

Pas pranimit të rekomandimeve nga ZLKZ për hapjen e qendrave të reja të votimit dhe identifikimi të emrave të rrugëve, divizioni i shërbimit të votuesve ka bërë caktimin të votuesve sipas adresave aktuale/ emrave të rrugëve në regjistrin qendror civil/ lista përfundimtare e votuesve 2021.

### a) Caktimi i votuesve për qendrat e votimit në zonat urbane

Tabela 3: Numri i qendrave të votimit, numri i rrugëve dhe numri i votuesve të identifikuar.

Komunat	Nr. i QV të rekomanduara	Nr. i rrugëve të identifikuara për QV	Nr. i votuesve sipas emrave të rrugëve
Gjakovë	2	81	17,050
Gjilan	4	216	14,838
Kaçanik	1	15	1,513
Klinë	1	25	3,140
Fushë Kosovë	1	13	1,207
Mitrovicë e Jugut	2	51	6,116
Podujevë	2	50	14,624
Prishtinë	7	300	29,100
Prizren	3	57	6,026
Suharekë	2	72	4,259
Ferizaj	3	112	9,827
Vushtrri	1	39	4,424

- Për 29 qendra të reja të votimit, janë identifikuar gjithsejtë: 1,322 emra të rrugëve.
- Prej 1,322 emra të rrugëve, votuesit janë identifikuar për vetëm 1,029 emra të rrugëve, ndërsa nuk ka pasur rezultate për 293 emra të rrugëve.
- Për 1,029 emra të rrugëve, janë identifikuar gjithsejtë: 112,124 votues. Ky numër përbën 14% të votuesve të caktuar në qendrat urbane (796,256) në Zgjedhjet Lokale 2021.

Për më shumë informata, pjesë e këtij raporti, është Shtojca 2: Të dhënat për QV e rekomanduara në zonat urbane.

### b) Caktimi i votuesve për qendrat e votimit në zonat rurale (fshatra)

Tabela 4: Numri i qendrave të votimit në fshatra.

Komunat	Nr. i QV të rekomanduara	Nr. i votuesve sipas emrave të rrugëve
Glogoc	2	/
Klinë	1	740
Mitrovicë e Jugut	2	
Vushtrri	1	1,600

Për më shumë informata, pjesë e këtij raporti, është Shtojca 3: Të dhënat për QV e rekomanduara në zonat rurale.

### 5.2. Ndryshimet pas caktimit të votuesve sipas adresave (emrave të rrugëve)

#### Shembull: Komuna e Prishtinës

##### Qendra aktuale e votimit 1902E – SH.M.L “Sami Frashëri”

- Qendra aktuale e votimit “1902E”, që gjendet në objektin e shkollës “Sami Frashëri” në Prishtinë, ka gjithsejtë: 5,855 votues.
- Si rezultat i krijimit të shtatë (7) qendrave të votimit në zonën urbane të Prishtinës, nga qendra e votimit 1902E, shkëputen 828 votues dhe caktohen në 7 qendrat e reja të votimit.

##### Qendra aktuale e votimit 1903E – SH.F.M.U “Faik Konica”

- Qendra aktuale e votimit “1903E”, që gjendet në objektin e shkollës “Faik Konica” në Prishtinë, ka gjithsejtë: 7,470 votues.
- Si rezultat i krijimit të shtatë (7) qendrave të votimit në zonën urbane të Prishtinës, nga qendra e votimit 1903E, shkëputen 1,171 votues dhe caktohen në 7 qendrat e reja të votimit.

##### Qendra aktuale e votimit 1906E – Fakulteti Filologjik

- Qendra aktuale e votimit “1906E”, që gjendet në objektin e fakultetit filologjik në Prishtinë, është qendra më e madhe e votimit, me gjithsejtë 19,348 votues.

- Si rezultat i krijimit të shtatë (7) qendrave të votimit në zonën urbane të Prishtinës, nga qendra e votimit 1906E, shkëputen 3,820 votues dhe caktohen në 7 qendrat e reja të votimit.
- Gjithashtu, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka bërë vlerësimin e të dhënave të votuesve për adresën, të cilët kanë qenë të caktuar në qendrën e votimit 1906E në objektin e Fakultetit Filologjik. Përgjatë vlerësimit, për bazë janë marrë adresat që si emërtim kanë lagjet, si: Dardani, Ulpianë, Arbëri, Veternik, Emshir/ Kalabri, Bregu i Diellit, Taslihxhë, Kolovicë, Lagja e Spitalit, Mati 1, Kodra e Trimave, rruga Bajram Kelmendi dhe Lakrishte. Numri i votuesve të identifikuar në bazë këtyre emërtimeve, është: 2,488. Në total, qendra aktuale e votimit 1906E, që ka 19,348 votues, i bie të ketë: 13,040, apo 6,308 votues më pak.

#### **Qendra aktuale e votimit 1904E – SH.F.M.U “Dardania”**

- Qendra aktuale e votimit “1904E”, që gjendet në objektin e shkollës “Dardania”, ka gjithsejtë 12,336 votues.
- Qendrat e reja të votimit “Xhemail Mustafa” dhe “7 Marsi” nga QV 1904E marrin gjithsejtë 2,902 votues.

#### **Qendra aktuale e votimit 1904E – SH.M.L “Ali Sokoli”**

- Qendra aktuale e votimit “1910E”, që gjendet në objektin e shkollës “Ali Sokoli, ka gjithsejtë 6,462 votues.
- Qendrat e reja të votimit “7 Marsi” që gjendet në lagjen Emshir dhe “Pavarësia” që gjendet në lagjen Mati 1, nga QV 1910E marrin gjithsejtë 1,460 votues.

#### **Qendra aktuale e votimit 1907E – Fakulteti Teknik**

- Qendra aktuale e votimit “1907E”, që gjendet në objektin e fakultetit teknik në Prishtinë, ka gjithsejtë: 6,402 votues.
- Qendrat e reja të votimit “7 Marsi” që gjendet në lagjen Emshir, Pavarësia” që gjendet në lagjen Mati 1, dhe “Xhemail Mustafa” që gjendet në lagjen Dardania, nga QV 1907E marrin gjithsejtë 1,405 votues.

#### **Shembull: Komuna e Podujevës**

#### **Qendra aktuale e votimit 1824E – Shkolla “Isla Boletini”**

- Qendra aktuale e votimit “1824E”, që gjendet në objektin shkollës Isa Boletini në Podujevë, është qendra më e madhe e votimit, me gjithsejtë 12,864 votues.
- Me krijimin e dy qendrave të reja të votimit në pjesën urbane të Komunës së Podujevës, në objektet shkollore Ibrahim Rugova dhe Xheladin Rekualliu, qendra

aktuale e votimit 1824E do të ketë 5,863 votues, për shkak se 7,101 votues janë caktuar në dy qendrat e reja të votimit, të rekomanduara nga ZLKZ.

**Për të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur si rezultat i krijimit të qendrave të votimit, pjesë e këtij raporti është e bashkangjitur: Shtojca 4: Ndryshimet nga caktimi i votuesve në qendrat e reja të votimit.**

### 5.3. Aktivitetet që duhet të ndërmerren në të ardhmen

Nr. i aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e realizimit
1	Kontrollimi dhe plotësimi i Listës së Qendrave të Votimit nga ZLKZ-të	12 -21 Tetor 2022
2	Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së Qendrave të Votimit nga KOZ dhe KQZ	24 Tetor - 3 Nëntor 2022
3	Integrimi i ndryshimeve nga Lista e Qendrave të Votimit në mekanizmin e caktimit të votuesve në Qendra të Votimit	7 Nëntor – 7 Dhjetor 2022
4	Takim me MPB/ ARC lidhur me bashkëpunimin përfshirë shtetasit që deri më 31 dhjetor 2023 mbushin moshën 18 vjeç	25 Janar - 10 Shkurt 2023
5	Kërkesë për Agjencinë e Regjistrimit Civil për ekstraktet e Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve dhe Departamentit të Gjendjes Civile, duke përfshirë shtetasit që deri më 31 dhjetor 2023 mbushin moshën 18 vjeç	13 – 28 Shkurt 2023
6	Caktimi i votuesve në Qendra të Votimit	1 – 31 Mars 2023
7	Krijimi i llogarive për çdo zyrtarë komunal të zgjedhjeve me qëllim të aprovimit/ refuzimit të kërkesave për ndërrim të QV-ve, që parashtron përmes ueb aplikacionit	1 – 30 Mars 2023
8	Publikimi i listës së votuesve në ueb faqen e KQZ-së	3 – 7 Prill 2023
9	Periudha e Shërbimit të Votuesve për ndërrimin e qendrave të votimit	7 Prill – 31 Dhjetor 2023
10	Kërkesë në baza mujore ARC/ DPD për të dhënat e votuesve që heqin dorë nga shtetësia dhe votuesve që registrohen si të vdekur	Maj, Qershori, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, dhe Dhjetor

#### **5.4. Rekomandimet**

1. Për rrugët që përshkojnë me shumë se një qendër të votimit, votuesit të caktohen në njëren nga ato qendra të votimit, në mënyrë që pastaj përmes periudhës së shërbimit të votuesve ta ndërrojnë qendrën e votimit.
2. Në pamundësi që votuesit të identifikohen vetëm me emra të rrugëve, të merret për bazë emërimi lagjes për caktim në qendër të votimit. Për shembull: në Komunën e Prishtinës, ka votues që si emër të rrugës e kanë “Lagja Mati 1” dhe ky emërtim duhet të shërbejë për caktim të këtyre votuesve në QV e rekomanduar në shkollën fillore “Pavarësia”.
3. Si rezultat i krijimit të qendrave të reja të votimit dhe votuesit që aktualisht kanë qenë të caktuar në qendra të votimit, njoftimi i tyre të bëhet duke shfrytëzuar mundësitet e dërgimit të mesazheve telefonike, duke përdorur bazën e të dhënavë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe platformën e shërbimeve online “E Kosova”. Platforma “E – Kosova”. Deri me datën 18 gusht 2022, në këtë platformë, numërohen 685,000 përdorues të regjistruar.
4. Për caktimin e vetëm një vendvotimi me kusht në kuadër të çdo komune, vendvotimi të caktohet në katet përdhese të qendrës së votimit dhe të caktohet në ato qendra të votimit, që kanë qasje të përshtatshme për kategori të ndryshme të votuesve.
5. Aktualisht të gjitha vendvotimet e rregullta, prapa kodit të qendrës së votimit dhe numrit rendor, kanë shkronjën R – për vendvotimet e rregullta dhe shkronjën D për vendvotimet e dyfishta (dual). Vendvotimet duhet të renditen vetëm me kodin e qendrës së votimit dhe numrin rendor, për shembull: 1901/01. Ndërsa, për vendvotimin me kusht duhet të caktohet kodi i vendvotimit, si për shembull: 1901/ 07K (nëse ka 6 vendvotime, vendvotimi i fundit të identifikohet me numrin rendor 07K).
6. Në listën që vendoset në vendvotimin me kusht, nuk do të renditen emrat e votuesve. Lista për vendvotimin me kusht do të shërbejë vetëm për votuesit që votojnë me kusht, duke përshkruar të dhënat e votimit me kusht në listën përfundimtare të votimit me kusht.
7. Caktimi i votuesve në qendra të votimit mbi baza etnike duhet të evitohet dhe votuesit të caktohen automatikisht. Pas këtij procesi, duhet të rishikohen qendrat e votimit, në të cilat janë caktuar votuesit mbi baza të etnisë.

## 6. Mbyllja e Qendrave aktuale të votimit

Zyrtarët Komunal të Zgjedhjeve gjatë muajit prill të vitit 2022 kanë bërë analizën e qendrave aktuale të votimit, dhe kanë propozuar që disa qendra të votimit të mbyllen dhe disa qendra të votimit të shkrihen në një qendër.

### 6.1. Mbyllja e qendrave të votimit

Kodi Komunal	Komuna	Vlerësimi:
07	Kaçanik	<p><b>Rekomandimi i ZLKZ-së:</b> Qendra e votimit 0718D, që gjendet në fshatin Kërbliq, rekomandohet të mbylljet për shkak numrit të vogël të votuesve dhe largësisë për të votuar në këtë qendër të votimit mbi 35 kilometra.</p> <p>Në listën përfundimtare të votuesve në Zgjedhjet Lokale 2021, 125 votues kanë qenë të caktuar që të votojnë në këtë QV. Ndërsa, në këtë QV kanë votuar vetëm 25 votues. Votuesit e kësaj qendre të votimit do të caktohen që të votojnë në qendrën e re të votimit, në shkollën Emin Duraku – Paralele e ndarë.</p>
05	Dragash	<p><b>Rekomandimi i ZLKZ-së:</b> Qendra e votimit 0501X të shuhet, dhe votuesit e kësaj qendre të caktohen të votojnë në 0501A, për shkak se qendra split e votimit 0501X, gjendet në të njëjtën rrugë me qendrën e votimit 0501A dhe kanë largësi 50 metra.</p>
13	Lipjan	<p><b>Divizioni i Shërbimit të Votuesve:</b> Qendra e votimit 1315E, që gjendet në shkollën Ismail Luma (në të njëjtin objekti shkollor si QV 1301E) ka gjithsejtë 179 votues. Kjo QV duhet të shuhet dhe votuesit të caktohen në QV 1301E.</p>
19	Prishtinë	<p><b>Divizioni i Shërbimit të Votuesve:</b> Si rezultat i krijimit të Qendrës së re të Votimit, SH.F.FM.U “7 Marsi” në Lagjen Emshir, shuhet qendra aktuale e votimit 1923E / Hoxhë Kadri Prishtina. Kjo QV, në Zgjedhjet Lokale 2021 ka pasur 2047 votues, ndërsa QV e Re “7Marsi” nga kjo qendër ka marrë 1,513 votues dhe votuesit e mbetur të QV 1923E janë shpërndarë në qendra të aktuale të votimit, sipas adresave.</p>
19	Prishtinë	<p><b>Rekomandimi i ZLKZ-së:</b> Qendra e votimit 1955E, që gjendet në fshatin nëntë Jugoviqët, rekomandohet të mbylljet për shkak të numrit të vogël të votuesve.</p> <p>Në Zgjedhjet lokale 2021, në këtë QV kanë qenë të caktuar që të votojnë 69 votues, ndërsa kanë votuar vetëm 4 votues.</p> <p>Votuesit e kësaj qendre të votimit, të caktohen që të votojnë në qendrën e votimit 1953E, në Bërnicën e Poshtme.</p>
19	Prishtinë	<p><b>Rekomandimi i ZLKZ-së:</b> Qendra e Votimit 1954E, që gjendet në Bërnicë të Epërme me numër të votuesve 1,245 të caktohen që të</p>

		<p>votojnë në Qendrën e Votimit 1931E, që gjendet në objektin shkollor “Anton Zako Çajupi, në Nëntë Jugovicët.</p> <p>Kjo qendër e votimit (1954E) në Zgjedhjet Lokale 2021 ka qenë e vendosur brenda objektit të qendrës së votimit 1931E Anton Zako Çajupi.</p>
22	Shtime	<p><b><u>Rekomandimi i ZLKZ-së:</u></b> Qendra e Votimit 2210E, e cila gjendet në objektin shkollorë të QV 2201E në SHFMU Emin Duraku në 2201X, të shuhet.</p> <p>Qendra e votimit 2210E në Zgjedhjet Lokale 2021, ka pasur gjithsejtë 136 votues në listën përfundimtare të votuesve, ndërsa kanë votuar rrëth 60 votues.</p> <p>Votuesit e qendrës së votimit 2210E të caktohen që të votojnë në qendrat aktuale të votimit QV 2201E ose 2201X.</p>
24	Suharekë	<p><b><u>Rekomandimi i ZLKZ-së:</u></b> Qendra e Votimit 2401A, që gjendet në objektin shkollor Jeta e Re, me numër të votuesve 9,881 në Zgjedhjet Lokale 2021, duhet të shuhet, për arsy se kjo qendër e ka infrastrukturën e tillë që është mjaft e vështirë për qasje të votuesve të kategorive të ndryshme, sepse hyrja i ka mbi 10 shkallë që duhet të kalohen për të tu qasur pastaj në vendvotime.</p>
27	Vushtri	<p><b><u>1. Rekomandimi i ZLKZ-së:</u></b> Qendra e votimit 2726B në fshatin Sllatinë (me 527 votues të caktuar në zgjedhjet lokale 2021) propozohet të mbyllët, pasi që ky objekt nuk shërben si institucion shkollorë që nga viti 2019. Votuesit e kësaj qendre të votimit të caktohen që të votojnë në qendrën e votimit 2704B, që gjendet në Vushtri.</p> <p><b><u>2. Rekomandimi i ZLKZ-së:</u></b> Qendra e votimit 2705B që gjenden në fshatin Skromë (me 371 votues të caktuar në zgjedhjet lokale 2021), propozohet të mbyllët, pasi që ky objekt shkollorë nuk shërben si institucion shkollorë që nga viti 2021. Votuesit e kësaj qendre të votimit të caktohen që të votojnë në qendrën e votimit 2732B, që do të hapet në zonën urbane të Vushtrisë, në shkollën Anton Zako Çajupi.</p>

## 6.2. Shkrirja e qendrave të votimit në një qendër të votimit

Kodi Komunal	Komuna	Vlerësimi:
19	Prishtinë	<p>Qendrat e Votimit 1901E dhe 1914E, gjenden brenda objektit shkollor Naim Frashëri në Prishtinë.</p> <p><b>Rekomandimi i ZLKZ-së:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kodi i Qendrës së Votimit 1914E largohet nga emërtimi i shkollës Naim Frashëri.</li> <li>- Shkolla fillor Naim Frashëri në Prishtinë do ta ketë kodin e qendrës së votimit 1901E.</li> </ul>
19	Prishtinë	<p>Qendrat e votimit 1914E dhe 1925E, gjenden në shkollën Meto Bajraktari në Prishtinë.</p> <p><b>Rekomandimi i ZLKZ-së:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kodi i Qendrës së Votimit 1925E largohet nga emërtimi i shkollës Meto Bajraktari.</li> <li>- Shkolla fillore Meto Bajraktari në Prishtinë, do ta ketë kodin e qendrës së votimit 1924E.</li> </ul>
19	Prishtinë	<p>Qendrat e votimit split: 1920X dhe 1921X, kanë qenë në një objekt shkollor.</p> <p>Pas largimit të qendrave split, kjo qendër e votimit do ta marr një kod, dhe do të konsiderohet një qendër e votimit.</p>

## 7. Vlerësimi i qendrave split të votimit

### 7.1. Përbledhje

Në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës 2021, votuesi kanë qenë të caktuar të votojnë në 883 qendra të votimit.

Nga 883 qendra të votimit gjithsejtë, 33 qendra të votimit janë qendra split. Votuesit në këto qendra të votimit caktohen sipas shkronjave të para të mbiemrave.

Në Zgjedhjet Lokale 2021, numri i votuesve që janë caktuar në këto qendra të votimit ka qenë: 196,116. Ndërsa, 33 qendra split të votimit kanë pasur gjithsejtë 230 vendvotime.

Shembull: Komuna e Pejës.

- Në komunën e Pejës, Për qendrën e votimit 1704C, ekzistojnë dy qendra të votimit, që konsiderohen qendra split, si: 1704X dhe 1704Y. Në këto qendra të votimit, votuesi caktohen sipas renditjes alfabetike të shkronjës së parë të mbiemrit.
- Në qendrën e votimit 1704C (13 vendvotime) caktohen të gjithë votuesit me shkronjën e parë të mbiemrit A deri në shkronjën J. Në qendrën e votimit 1704X (10 vendvotime) caktohen të gjithë votuesit me shkronjën e parë të mbiemrit K deri në shkronjën N. Në qendrën e votimit 1704Y (7 vendvotime) caktohen të gjithë votuesit me shkronjën e parë të mbiemrit O deri në shkronjën Ë.

## 7.2. Qendrat split të votimit

Qendrat split të votimit (33 gjithsejtë) ekzistojnë në njëzet e dy (22) komuna të Republikës së Kosovës.

Tabela 5: Numri i qendrave split të votimit sipas Komunave të Republikës së Kosovës.

Kodi Komunal	Komuna	Qendra Split e Votimit	Numri i QV split
01	Deçan	0101X	1
02	Gjakovë	0202X	2
		0203X	
03	Glogoc	0301X	1
04	Gjilan	0401X	3
		0402X	
		0403X	
05	Dragash	0501X	1
07	Kaçanik	0701X	1
09	Fushë Kosovë	0901X	1
10	Kamenicë	1001X	1
11	Mitrovicë e Jugut	1102X	1
12	Leposaviq	1201X	1
13	Lipjan	1301X	1
16	Rahovec	1602X	1
17	Pejë	1704X	3
		1704Y	
		1705X	
18	Podujevë	1801X	1
19	Prishtinë	1919X	3
		1920X	
		1921X	
20	Prizren	2005X	2
		2006X	
21	Skenderaj	0101X	1
22	Suahrekë	2201X	1
25	Ferizaj	2501X	4
		2501Y	
		2502X	
		2503X	
26	Viti	2601X	1
27	Vushtrri	2702X	1
38	Mitrovicë e Veriut	3805X	1

### **7.3. Rekomandimet**

#### **Përshkrimi:**

- a) Në Zgjedhjet e kaluara, votuesit që kanë kërkuar ndërrimin e qendrës së votimit, kërkesat e tyre janë refuzuar për shkak që kanë kërkuar të caktohen që të votojnë ose në qendrat split të votimit ose në qendrat amë të votimit, ku arsyja e refuzimit ka qenë për shkak se shkronja e mbiemrit nuk përkon me kriterin e ndarjes.
  - Në Zgjedhjet Lokale 2021, 774 kërkesa për ndërrim të qendrës së votimit janë refuzuar për arsyen më lartë (nga 7,769 kërkesa të aprovuara)
  - Në Zgjedhjet Parlamentare 2019, 1092 kërkesa për ndërrim të qendrës së votimit janë refuzuar për arsyen më lartë (nga 2,403 kërkesa të aprovuara).
  - Në Zgjedhjet Lokale 2017, 809 kërkesa për ndërrimin të qendrës së votimit janë refuzuar për arsyen më lartë (nga 7,409 kërkesa të aprovuara).
- b) Në pjesët e zonave urbane të disa qyteteve, qendrat split të votimit janë të ngarkuara, me numër të madh të votuesve dhe vendvotimeve, duke arrit pikën kritike, për arsy se këto qendra nuk kanë kapacitete (vendvotime) për të caktuar votues, duke përfshirë edhe qendrat amë të votimit.
  - Në Gjakovë, Qendra split e Votimit, 0202X (Shkolla Ylli Morina) përmban gjithsejtë 18 vendvotime.
  - Në Gjilan, Qendra split e Votimit, 0401X (Shkolla Thimi Mitko) përmban gjithsejtë 20 vendvotime.

#### **Rekomandimet:**

1. Qendrat split të votimit duhet të shuhen dhe kriteri për ndarjen/ caktimin e votuesve sipas shkronjës së parë të mbiemrit nuk duhet të aplikohet.
2. Për zgjedhjet e ardhshme, votuesit që janë caktuar në qendra split të votimit, të mbesin në këto qendra të votimit, nëse nuk kanë ndryshuar adresat.
3. Votuesve të caktuar në këto qendra të votimit dhe në qendrat amë të votimit, t'i mundësohet ndërrimi i qendrës së votimit.

## 8. Vlerësimi i vendvotimeve për qendra të votimit

### 8.1. Përbledhje e të dhënave për numrin e vendvotimeve

Në Zgjedhjet Lokale të vitit 2021, votuesit kanë qenë të caktuar që të votojnë në 883 qendra të votimit dhe në 2,477 vendvotime. Prej 883 qendra të votimi:

- 295 qendra të votimit – Një (1) vendvotim.
- 268 qendra të votimit – Dy (2) vendvotime.
- 128 qendra të votimit – Tri (3) vendvotime.
- 60 qendra të votimit – Katër (4) vendvotime.
- 46 qendra të votimit – Pesë (5) vendvotime.

**797 qendra të votimit në Kosovë, kanë deri në 5 vendvotime.**

---

- 20 qendra të votimit – Gjashtë (6) vendvotim.
- 22 qendra të votimit – Shtatë (7) vendvotim.
- 10 qendra të votimit – Tetë (8) vendvotime.
- 7 qendra të votimit – Nëntë (9) vendvotime.
- 5 qendra të votimit – Dhjetë (10) vendvotime.

**64 qendra të votimit në Kosovë, kanë nga 6 deri në 10 vendvotime.**

---

**18 qendra të votimit në Kosovë, kanë nga 11 deri në 18 vendvotime.**

---

**4 qendra të votimit në Kosovë, kanë nga 20 deri në 22 vendvotime.**

---

### 8.2. Vlerësimi i hapësirave të qendrave të votimit nga ZLKZ-të

Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve kanë bërë vlerësimin e hapësirave që shfrytëzohen si vendvotime në kuadër të secilës qendër të votimit.

Nga ky vlerësim rezulton se, nga 883 qendra të votimit aktualisht:

- a) 722 qendra të votimit i shfrytëzojnë vendvotimet vetëm në katin përdhese (81.76%),
- b) 95 qendra të votimit i shfrytëzojnë vendvotimet që gjinden në katin e parë (10.75%),
- c) 11 qendra të votimit i shfrytëzojnë vendvotimet që gjinden në katin e dytë (1.24%).

*Tabela 6: Të dhënat për shfrytëzimin e hapësirave që përdoren si vendvotime*

Kodi Komunal	Komunat	Numri i QV-ve	Nr. i QV-ve me VV në katin përdhese	Nr. i QV-ve me VV në katin e parë	Nr. i QV-ve me VV në katin e dytë
01	Deçan	14	12	2	0
02	Gjakovë	34	28	6	0
03	Gjilogoc	29	25	4	0
04	Gjilan	34	10	18	4
05	Dragash	34	28	6	0
06	Istog	21	20	1	0
07	Kaçanik	21	18	3	0
08	Klinë	20	19	1	0
09	Fushë Kosovë	15	13	2	0
10	Kamenicë	28	28	0	0
11	Mitrovicë e Jugut	28	24	4	0
12	Leposaviq	18	18	0	0
13	Lipjan	34	34	0	0
14	Novobërdë	18	17	1	0
15	Obiliq	15	14	1	0
16	Rahovec	35	34	1	0
17	Pejë	24	12	12	0
18	Podujevë	45	43	2	0
19	Prishtinë	52	/	/	/
20	Prizren	71	55	10	6
21	Skenderaj	33	33	0	0
22	Shtime	16	15	1	0
23	Shtërpçë	9	8	1	0
24	Suharekë	33	31	2	0
25	Ferizaj	44	39	5	0
26	Viti	31	29	2	0
27	Vushtrri	32	30	2	0
28	Zubin Potok	12	11	1	0
29	Zveçan	7	6	1	0
30	Malishevë	35	35	0	0
31	Junik	1	0	1	0
32	Mamushë	1	/	/	/
33	Hani i Elezit	4	3	1	0
34	Graçanicë	13	12	1	0
35	Ranillug	7	7	0	0
36	Partesh	3	1	1	1
37	Kllokot	5	5	0	0
38	Mitrovicë e Veriut	7	5	2	0
<b>TOTALI</b>		<b>883</b>	<b>722</b>	<b>95</b>	<b>11</b>

## 9. Lista e Qendrave të Votimit

### 9.1. Përbledhje

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme qendra e votimit nuk duhet të jetë një vend i kultit, ndërtesë e cila është pronë apo seli e subjektit politik, ose hapësira në të cilat shërbehet apo konsumohet alkooli. Ndërsa sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 16/ 2013 për themelimin e qendrave të votimit, qendra e votimit themelohet në:

- ndërtesa të institucioneve publike (arsimore, kulturore, sportive), dhe
- ndërtesa private në pronësi të personave fizik ose juridik (kur kjo miratohet nga KQZ).

Aktualisht, në Kosovë, si qendra të votimit shfrytëzohen:

- 849 objekte shkollore, që përfshin shkollat fillore të mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta,
- 5 objekte universitare,
- 4 shtëpi të kulturës,
- 3 objekte të mjekësisë familjare,
- 3 objekte të bashkësive lokale, dhe
- 1 objekt fetar (që është në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme).

Siç shihet më lartë, rreth 96% e qendrave të votimit gjenden në objektet shkollore, duke përfshirë shkollat fillore dhe shkollat e mesme.

### 9.2. Kodifikimi i Qendrave të Votimit

Kodifikimi i Qendrave të Votimit është i bazuar në kodin katër shifrëve, ku dy shifrat e para kanë të bëjnë me kodin komunal, dy shifrat e fundit kanë të bëjnë me renditjen e qendrës së votimit dhe shkronja e fundit përcakton zonën e hartografisë së territorit të Kosovës, që me gjasë janë krijuar nga KFOR-i.

- Shkronja A: përcakton pjesën jugore të territorit të Kosovës.
- Shkronja B: përcakton pjesën veriore të territorit të Kosovës.
- Shkronja C: përcakton pjesën perëndimore të territorit të Kosovës.
- Shkronja D: përcakton pjesën lindore të territorit të Kosovës.

Për më shumë, shkronjat e fundit janë të identikuara me kodet e qendrave të votimit për komunat si në vijim:

- Shkronjën A, e përbajnjë qendrat e votimit të komunave: Dragash, Rahovec, Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Mamushë.

- Shkronjën B, e përmbajnë qendrat e votimit të komunave: Mitrovicë e Jugut, Leposaviq, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.
- Shkronjën C, e përmbajnë qendrat e votimit të komunave: Deçan, Gjakovë, Istog, Klinë, Pejë dhe Junik.
- Shkronjën D, e përmbajnë qendrat e votimit të komunave: Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Novobërdë, Shtërpcë, Ferizaj, Viti, Hani i Elezit, Ranillug, Partesh dhe Kllokot.
- Shkronjën E, e përmbajnë qendrat e votimit të komunave: Gllogoc, Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Shtime dhe Graçanicë

### **9.3. Renditja e qendrave të votimit sipas numrave renderë**

Qendrat e Votimit në Kosovë, deri në një masë, janë të renditura sipas numrave render. Në disa komuna qendrat e votimit nuk janë të renditura sipas numrit render.

Për shembull:

- Në komunën Zveçanit, qendra e parë fillon me kodin: 2901B, dhe vazhdon me kodin: 2910B,
- Në komunën e Malishevës, qendra e parë e votimit fillon me kodin: 3001A, dhe vazhdon me kodin 3108A. Pastaj, nga kodi 3008A, vazhdon me kodin 3012A.
- Në komunën e Prishtinës, qendra e votimit që ka kodin 1943E, nuk ka vazhdimësi të numrit render, dhe pas këtij kodi, vazhdohet me kodin e QV-së: 1953E.

Në parim, kodet e para të qendrave të votimit janë të përcaktuara për qendrat e votimit që gjenden në zonat urbane. Ka disa komuna, që nuk është ndjekur ky parim.

Për shembull:

- Në komunën e Podujevës, 4 qendrat e para të votimit me kode të identikuara i takojnë zonës urbane, e pastaj fillon kodifikimi i qendrave të votimit në fshatra, ku vazhdon kështu, deri te kodifikimi i qendrës së votimit 1824E, që gjenden në zonën urbane.

### **9.4. Emërtimi i objekteve që shfrytëzohen si qendra të votimit**

Objektet që shfrytëzohen si qendra të votimit nuk përmbajnë emërtimi standarde. Objektet shkollore për shembull janë të shkruara si: "Shkolla", "Shkolla fillore" SH.F.M.U, SH.M.L, Gjimnazi, etj.

Pastaj, ka emërtime të pa specifikuara: Ndërtesë publike, Fakulteti Juridik, Fakulteti Filologjik, etj.

## 9.5. Rekomandimet

1. Sipas Ligjit Nr. 04/ L-032 për Arsimin para universitar në Republikën e Kosovës, sistemi i arsimit është i organizuar, si në vijim: Arsimi parashkollar, Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (që nënkupton shkollat fillore të mesme të ulëta) dhe Arsimi i mesëm i lartë (që nënkupton shkollat e mesme të larta).
  - Për objektet që shfrytëzohen si qendra të votimit dhe që janë shkolla fillore të mesme të ulëta, të përdoret shkurtesa: SH.F.M.U. **Shembull: SH.F.M.U “Naim Frashëri”**
  - Për objektet që shfrytëzohen si qendra të votimit dhe që janë shkolla të mesme të larta, të përdoret shkurtesa: SH.M.L. **Shembull: SH.M.L “Gjin Gazulli”**
  - Për objektet që shfrytëzohen si qendra të votimit dhe që janë objekte universitare, të përdoret emërtimi si në vijim: **Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Objekti i Fakultetit Filologjik**
  - Për objektet që shfrytëzohen si qendra të votimit dhe që janë objekte private, të përdoret emërtimi si në vijim: **Ndërtesë private në pronësi të personit fizik**
2. Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 14/ 2019 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Zonë e Qarkullimit Publik (ZQP) konsiderohen: rrugët, bulevardet, rrethet, sheshet, dhe parqet. Pra, zonë e qarkullimit publik nuk konsiderohet lagja.
  - Lista e qendrave të votimit tek informatat për Qytetin/ Vendin përmban emërtime që nuk janë zyrtare. Për shembull: Qendra e votimit 1901E, tek fusha “Qyteti/ Vendi” e ka përshkrimin Prishtinë – Mahalla e Muhamherëve.
  - Të gjitha qendrat e votimit të renditura në listë, përveç vendit, duhen ta kenë adresën zyrtare, me emrin rrugës dhe numrin e hyrjes, për shembull: **Rruja: "Dëshmorët e Kombit", nr. 75**

Lista e Qendrave të Votimit që përbën numrat e renditur sipas rendit dhe informatat e tjera shtesë, përbën **Shtojcën 5: Draft Lista e Qendrave të Votimit.**